KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"
QENDRA KËRKIMORE

STRATEGJIA DHE PLANI I PUNËS AFATMESËM I KËRKIMIT SHKENCOR
(PËR PERIUDHËN 2019 – 2024)

(Miratuar me Vendim nr. 28, datë 16.12.2019, të Senatit Akademik)

Vlorë, dhjetor 2019

Vizioni:

1. Të sigurojë cilësi të lartë në veprimtarinë akademike në çdo program studimi të nivelit të parë e të dytë dhe në programet dyvjeçare në mënyrë që të përgatisë studentët e sotëm e specialistët e ardhshëm për të përballuar sfidat në karrierë në tregun e punës në një botë globale e të hapur të dijes që ndryshon me ritme të shpejta.

2. Cilësia e institucionit tonë mbështetet në organizimin ndërveprues menaxherial, në kërkimin shkencor të vazhdueshëm, në mësimdhënien e mësimnxënien e suksesshme të drejtuar nga një staf akademik me përvojë të pasur e me energji të reja, në pajisjet moderne bashkëkohore laboratorike, ku zhvillohen me efektivitet praktikat profesionale dhe në bibliotekën e pasur me literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja në shërbim të studentëve dhe të pedagogëve.

Misioni:

Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",* misioni i këtij institucioni do të jetë:

1. Të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor;
2. Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me përparësitë e zhvillimit të vendit dhe të rajonit duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
3. Të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
4. Të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe t'i edukojë studentët me frymën dhe metodologjinë e kërkimit të mirëfilltë shkencor;
5. Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë;
6. Të garantojë liri akademike nëpërmjet të drejtës për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit dhe ato krijuese;
7. Të përzgjedhë në procesin e mësimdhënies e në kërkimin shkencor specialistët më të mirë duke u përqendruar tek ata me tituj e grada shkencore e me përvojë dhe te specialistët e rinj me mesatare të lartë, me një nivel të përparuar e bashkëkohor teorik dhe me energji të reja për të synuar formimin e vazhduar gjatë gjithë jetës;
8. Strategjia e qendrës së kërkimit shkencor do të jetë në përputhje me strategjinë e Kolegjit Universitar "Reald" që ka përparësi: cilësinë, barazinë dhe standardet në arsim, tërheqjen në radhë të parë të elementëve të talentuar, gjenerimin e ideve të reja dhe menaxhimin e informacionit në fushën e kërkimit shkencor;
9. Krijimin e një klime që reflekton idetë e përbashkëta, vlerat, vizionin;

10. Besimin dhe që karakterizohet nga baraspesha midis mbështetjes dhe nxitjes;
11. Zbatimin e kodit etik si një dokument i bazuar me integritetin profesional e vetjak, në respektin e ndërsjelltë, në përgjegjshmërinë dhe në arritjet akademike njëkohësisht;
12. Cilësinë e institucionit, që mbështetet në organizimin ndërveprues menaxherial, në kërkimin shkencor të vazhdueshëm, në mësimdhënien e suksesshme dhe pajisjen moderne bashkëkohore laboratorike, ku zhvillohen me efektivitet praktikat profesionale.

Objektivat kryesore në funksion të strategjisë:

1. Nëpërmjet këshillimit të karrierës dhe në bashkëpunim me stafin akademik të ndihmohen maturantët të planifikojnë hapat për shkollimin e mëtejshëm bazuar në vendimmarrje të mirëmenduara për të ardhmen e tyre për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë dhe për t'u punësuar sipas prirjeve të tregut të punës;
2. Të përgatisë farmacistë, stomatologë, infermierë, fizioterapistë e teknikë laboratori të profilizuar, të aftë teorikisht dhe praktikisht për t'iu përgjigjur pacientëve në të gjitha profilet e mjekësisë me një shërbim cilësisht të ri dhe me më shumë përkujdesje për mbrojtjen e shëndetit;
3. Të përgatisë ekonomistë të aftë për përballimin cilësor të sfidave të ekonomisë së tregut në kuadrin e globalizmit;
4. Të përgatisë specialistë të kualifikuar për asistent administrativë dhe ndihmës dentarë në programet dyvjeçare;
5. Të përmbushë kushtet e përcaktuara nga strukturat e Edukimit në Vazhdim si pjesë e formimit dhe kualifikimit të përhershëm të stafit akademik;
6. Të bëjë me dije kushtet e reja të zhvillimit profesional për studentët kandidatë për diplomim, duke i angazhuar ata në punë kërkimore shkencore dhe në konferenca e seminare me tematikë të përcaktuar;
7. Studentët e pedagogët të jenë në vazhdimësi në kontakt me risitë dhe me literaturën bashkëkohore të shkruar ose elektronike;
8. Të inkurajohet ndërtimi i urave lidhëse midis studentëve që zhvillojnë detyra kursi e punë kërkimore, stafit akademik dhe udhëheqësve të temave të diplomave të nivelit të parë e të dytë;
9. Me hapjen e programit të doktoraturës do të synohet të vazhdojnë studimet doktorale një pjesë e stafit të kërkimit shkencor dhe të departamenteve të tjera.

Plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor (Drejtimet kryesore):

1. Ndjekja në vazhdimësi e punës kërkimore shkencore të Kolegjit.
2. Evidentimi i botimeve të stafit akademik dhe ndjekja e punës kërkimore shkencore të tyre (përgjegjësit e departamenteve, në vazhdim).

3. Të kryhen studime për rajonin, për monitorimin dhe informacionin mbi ndotjet mjedisore, për vlerësimin e shkallës së ndotjen së ujërave në Rajonin e Vlorës, për zhurmat si një agresivitet në rritje ndaj shëndetit të njeriut, për mbetjet organike dhe modelimin e proceseve biokimike, për gjeomjedisin e gjeoturizmin, për gjendjen ekologjike të plazheve, lagunave dhe deltave të lumenjve për mbetjet e pesticideve në produktet ushqimore (bimë, fruta, pije), për ndotje bakteriologjike në ujërat sipërfaqësore të Qarkut të Vlorës e më gjerë për ndotjet nga pluhurat PM10, për monitorimin e radonit dhe radioaktivitetin mjedisor etj.
4. Të kryhen studime për politikat e shëndetit publik, për stresin si një faktor rreziku për shëndetin mendor dhe fizik, për mjekësinë moderne rehabilituese, për profilaksinë, për administrimin e medikamenteve dhe sigurinë e pacientit dhe studime stomatologjike, studime për efektet e trajtimeve fizioterapeutike etj.
5. Të kryen studime në fushën ekonomike me drejtim menxhimin, financën, kontabilitetin, etj.
6. Të botohet periodikisht Buletini Shkencor "Reald", ku do të përfshihen studime të stafit akademik të kolegjit dhe institucioneve të tjera të larta brenda dhe jashtë vendit etj.
7. Të bëhet studimi dhe vlerësimi i punimeve studimore shkencore për t'u pranuar për botim.
8. Të organizohen biseda, seminare, leksione të hapura me pedagogë e studentë ku të diskutohet e të shkëmbehet përvojë për platformën dhe standardet e përgatitjes së temave nga studentët.
9. Të jepen vazhdimisht këshillime për mënyrën e përgatitjes së temave të diplomës dhe të mikrotezës për studentët.
10. Të vazhdojë bashkëpunimi me universitetet italiane të Salernos, Barit, Foggia-s etj., si dhe me universitete të tjera brenda e jashtë vendit për të shkëmbyer përvojë e për të bërë veprimtari të përbashkëta, si konferenca shkencore, simpoziume shkencore, workshop-e, seminare etj.
11. Të menaxhohet e të monitorohet puna për informimin e publikut dhe bërjen të njohura të arritjeve në fushën akademike dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet publikimeve, promovimeve dhe formave të tjera.
12. Të pasurohet biblioteka e Kolegjit me literaturë bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja sipas sylabuseve dhe kërkesave të departamenteve për t'i ardhur në ndihmë stafit akademik dhe studentëve për arritje cilësore në procesin mësimor e në punën kërkimore shkencore.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Spiro CAUSHI